



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Departamenti i Ligjit dhe i të Drejtave të Njeriut Njësia e të Drejtave të Njeriut

Vëzhgim i gjendjes së sistemit të paraburgimit

Metodologjia

Vëzhgimi i gjendjes së sistemit të paraburgimit në Shqipëri filloi në qershor 2003, si një nismë e Njesisë së të Drejtave të Njeriut. Të gjitha Zyrrave Rajonale të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri iu shpërnda një pyetësor me 25 pyetje (shiko Aneksin I). Gjatë periudhës Korrik – Gusht 2003, Zyrrat Rajonale vizituan të 25 qendrat e paraburgimit në Shqipëri.

Vizitat u kryen sipas planit të mëposhtëm:

- Zyrrat Rajonale kontaktuan Shefin e Policisë me gradë më të lartë që gjendej në detyrë në momentin e vizitës dhe e informuan atë në lidhje me qëllimin e kësaj vizite;
- Zyrrat Rajonale i drejtuan Shefit të Policisë pyetjet e pyetësorit që ishin përgatitur për policinë;
- Përfaqësuesit e Zyrrave Rajonale vizituan dhomat e paraburgimit;
- Ata kërkuan leje për të folur privatisht me disa nga personat që ndodheshin në paraburgim dhe u drejtuan atyre pyetjet e pyetësorit që ishin përgatitur për ta;
- Bënë një vlerësim të situatës bazuar në opinonet e tyre personale
- Falenderuan policinë për bashkëpunimin.

Përfaqësuesit e Zyrrave Rajonale ishin këshilluar të informonin policinë rreth gjysmë ore para vizitës së tyre, në mënyrë që të siguroheshin për disponueshmërinë e tyre.

Sipas përfaqësuesve të OSBE-së, u krijua mundësia që të gjitha intervistat me të paraburgosurit të bëheshin privatisht. Sjellja e oficerëve të policisë u përshkrua si me cilësi dhe shume prej tyre edhe falenderuan përfaqësuesit e Zyrrave Rajonale për vizitën që po u bënin dhomave të paraburgimit dhe e vlerësuan rifreskimin e vëzhgimit të gjendjes së tyre.

Informacion i përgjithshëm rreth sistemit të paraburgimit në Shqipëri

1. Në Shqipëri gjenden 25 qendra paraburgimi. Ato ndodhen pranë ose brenda godinave të komisariateve respektive të policisë (shiko Aneksin II). Megjithëse ka pasur shumë përpjekje për të rindërtuar disa nga këto qendra, kushtet e tyre janë shumë të këqija. Kapaciteti i përgjithshëm i paraburgimit është prej 825 personash, por sipas të dhënave të Ministrisë së Rendit Publik, numri i personave që ndodheshin atje gjatë qershorit 2003 ishte

1416 persona, 384 prej të cilëve ishin të dënuar me vendim të formës së prerë (shiko Aneksin III).

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 15 maj 2003 “Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”¹ vendosi transferimin e dhomave të paraburgimit nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë. Bazuar në këtë vendim, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Drejtësisë, nënshkruan një marrëveshje për të bërë një proces transferimi hap pas hapi për kalimin e paraburgimit nga njëra ministri në tjetrën. Ky proces, që duhet të fillonte në gusht 2003 dhe të përfundonte në prill 2004, filloi në shtator 2003, kur dhomat e paraburgimit pranë komisaritit të policisë së Vlorës, qenë të parat që u morën nën përgjegjësinë e Policisë së Burgjeve.

Kushtet fizike të dhomave të paraburgimit

3. Personeli i OSBE-së vizitoi një total prej 316 dhomash paraburgimi. Numri i personave në çdo dhomë varionte nga 1 në 19 persona, në varësi të përmasave të saj. Gjithsesi, ky parim nuk respektohej gjithmonë, përderisa në disa vende, siç ishte rasti i Sarandës, u vunë re dhoma të vogla ku ishin vendosur më shumë persona se në dhoma më të mëdha. Kushtet e dhomave të paraburgimit lënë shumë për të dëshiruar. Ambjenti është i paajrosur dhe vjen erë shumë e keqe. Infrastruktura e tyre, megjithë disa përpjekje të bëra vitet e fundit për të rikonstruktuar disa prej dhomave, është shumë e vjetër.

4. Dhomat e paraburgimit janë tepër të vogla, disa prej tyre shkojnë me përmasa 1,5 m x 4m. Në shumë komisariate, personat brenda tyre ishin të detyruar në shtriheshin në brinjë, njëri pas tjetrit, si në një kuti sardesh, ose madje mund t’u duhej të flinin edhe me turne. Dhoma shumë të vogla paraburgimi me një sipërfaqe prej 2m² janë vënë re në Skrapar dhe Berat, ndërsa një dhomë shumë e vogël prej më pak se 1m² është raportuar në Përmet. Dhomat e paraburgimit nuk kanë ndonjë mobilim ose pajisje, por vetëm thjesht dyshekë dhe batanije të vendosura mbi dysheme ku shtrihen të paraburgosurit. Ato janë shumë të nxehta në verë dhe tepër të ftohta në dimër dhe nuk kanë ajrosje. Për shkak të mbipopullimit, mosajrimit dhe lagështirës, krijohet një ambjent shumë i keq për ata që ndodhen brenda. Një gjë e tillë rëndohet gjatë peridhës së verës, e cila ishte dhe koha kur u bë vëzhgimi, kur temperaturat arrijnë mbi 35°C. Rasti më i keq është vënë re në paraburgimin e Shkodrës ku të paktën 19 persona ishin vendosur në një dhomë paraburgimi, e cila kishte vetëm dy dritare shumë të vogla dhe mungesë ajrimi. Problemet e tjera që shqetësojnë gjithë vendin si mungesa e dritave apo e ujit, e keqësojnë gjendjen akoma më shumë.

5. Megjithëse shumica e dhomave të paraburgimit ishin në përgjithësi të pastruara, kushtet higjienike ishin shumë të këqija. Në Durrës u vunë re insekte, si brumbuj, që dilnin nga dërrasat e vendosura në dysheme dhe silleshin rrotull qeseve me ushqim, të cilat të paraburgosurit i mbanin afër vendeve ku flinin. Në asnjë prej paraburgimeve nuk kishte ndonjë hapësirë frigoriferike që të paraburgosurit t’i përdornin për të mbajtur këto ushqime.

6. Mbipopullimi duket se është një nga problemet më të mëdha të paraburgimit në Shqipëri. Gjatë vëzhgimit është vënë re se numri i të paraburgosurve në qelitë e Fierit ka qënë tre herë më i madh se kapaciteti, me 144 persona që qëndronin në një kapacitet prej 48 personash. Për shkak të mbipopullimit, por edhe të numrit të vogël të qelive dhe numrit të

¹ Shiko Fletotja Zyrtare nr. 46, qershor 2003

madh të të dënuarve me vendim të formës së prerë, policia e ka pothuajse të pamundur të ndajë minorenët (fëmijët) nga të rriturit, ose personat e dënuar nga ata të padënuar. Janë raportuar raste kur ka pasur minorenë që kanë ndenjur në të njëjtën qeli me të rritur që kanë kryer krime të rënda si vrasje apo grabitje me armë.

7. Shërbimi mjekësor në paraburgim zakonisht mungon. Lagështira e madhe dhe ajrimi i keq shkaktojnë probleme të frymëmarrjes, sidomos për të moshuarit. Shumë prej tyre ankoheshin se ishte tejet e vështirë për të pasur një trajtim mjekësor. Disa prej tyre thanë se nuk kishin mundësi të paguanin për një trajtim të tillë, kurse të tjerë u ankuan se e kishin pasur pothuajse të pamundur t'i vizitonte një mjek ose të merrnin edhe mjekimin më të thjeshtë. Një nga të paraburgosurit u ankua se meqënëse nuk kishte familje që ta ndihmonte, e kishte të pamundur të siguronte mjekim për alergjitë që i kishin filluar pas arrestimit. Po ky i paraburgosur tregoi se në shumë raste disa policë ua kishin blerë ilaçet të paraburgosurve me paratë e tyre. Por nga kontaktet me të paraburgosur të tjerë, përfaqësuesve të OSBE-së iu krijua dyshimi se të paraburgosurve u është dashur të paguajnë ryshfet për të marrë mjekim ose përkujdesje mjekësore.

8. Çështja e të paraburgosurve që paraqesin probleme mendore mbetet problematike. Janë raportuar gjashtë të paraburgosur me probleme mendore në Fier, ndërsa në Krujë një i paraburgosur me çrregullime mendore mbahej në paraburgim që prej vitit 2001. Policët e kishin çuar këtë person në spital për përkujdesje mjekësore disa herë. Një rast tjetër për t'u shqetësuar ishte ai i një personi në paraburgimin e Mirditës i cili ishte arrestuar para tre vejtësh dhe ishte shpallur i sëmurë mendor nga gjykata menjëherë pas kësaj. Megjithëse gjykata kishte vendosur që ky person duhej dërguar në njësinë psikiatrike të Krujës, policia e Mirditës ishte akoma në pritje të urdhërit për këtë transferim. Meqënëse ky person, për shkak të shqetësimeve që shfaqte, nuk mund të mbahej në dhomat e paraburgimit, ai mbahej në spitalin lokal nën masa sigurie. Shefi i komisariatit dhe kolegët e tij e konsideronin këtë si problem për shkak se një pjesë e forcave policore duhej të rrinte me të, por e konsideronin edhe një mënyrë të papërshtatshme për të mbajtur një të burgosur për një kohë të gjatë.

9. U vu re se ushqimi i shërbyer në paraburgim ishte shumë i keq. Të paraburgosurve u jepeshin tre herë në ditë. Ushqimi është gjithmonë i njëjti dhe në menunë e përditshme shërbehej supë dhe patate me vetëm 20 gramë mish në ditë. Si pasojë, shumica e tyre parapëlqenin të konsumonin ushqimet që u sillnin familjet. Meqënëse brenda në qeli nuk ka vende të caktuara për të konsumuar ushqimin, të paraburgosurve u duhej të hanin të ulur direkt mbi dysheme.

10. Të paraburgosurit kanë mungesë totale të mundësisë për të kaluar kohën e lire, dhe kanë kohë ajrimi të pamjaftueshme. Ata nuk kanë akses në media si dhe nuk kanë mundësi kontaktimi me institucione apo përfaqësues fetarë. Kushtet e jetesës janë shumë të vështira dhe aktivitetet e të paraburgosurve konsistojnë vetëm në pirje duhani, bisedat me njëri-tjetrin dhe të fjeturit.

Kushtet sanitare

11. Zakonisht çdo paraburgim ka 1-2 tualete, të cilat të paraburgosurit mund t'i përdorin tre herë në ditë. Në rast nevojë, bazuar edhe mbi Rregulloren e Paraburgimit, ata mund t'i përdorin ato më shpesh, por në disa paraburgime, si p.sh. në Kukës, kjo gjë nuk lejohej edhe

në rast se personi kishte probleme shëndetsore si diarreja. Tualetet përgjithësisht pastrohshin, por infrastruktura e tyre është shumë e keqe dhe ato nuk janë ristruktuar prej vitesh.

12. Zakonisht çdo paraburgim ka një dhomë dushi të cilën çdo i paraburgosur mund ta përdorë përafërsisht një herë në dhjetë ditë. Infrastruktura e dusheve është shumë e keqe, madje në disa raste ata konsistojnë vetëm në një vrimë në mur nga e cila del uji. Dushtet zakonisht nuk janë të pastra, ndërsa në paraburgimin e Përmetit nuk ka fare dush dhe të paraburgosurit duhet të laheshin “me kanaçe”. Edhe pse autoritetet e paraburgimit shprehin dëshirën e tyre të mirë për të lejuar të paraburgosurit të laheshin më shpesh, fakti që ka vetëm një dush për rreth një qind persona, nuk lë mundësi përmirësimi.

13. Të paraburgosurit mund të rruhen përafërsisht një herë në javë dhe mund të presin flokët një herë në një ose dy muaj. Ata lejohen të përdorin sapun dhe furça dhëmbësh si dhe mund t'i gëzojnë të gjitha këto shërbime para se të paraqiten në gjykatë.

Ushtrimet fizike

14. Gjatë ditës të paraburgosurit nuk kanë mundësi të kryejnë ushtrime fizike. I vetmi variacion është shëtitja e përditshme në dhomën e ajrimit ose në oborrin e rajonit të policisë, e cila shkon nga 30 minuta deri në një orë në ditë. Dhoma e ajrimit konsiston në një hapësirë të rrethuar nga mure të larta deri në tre metra e mbuluar me rrjetë hekurash. Fare mirë ajo mund të përkufizohet një qeli që i mungon çatia. Në shumë prej paraburgimeve, lagështia e këtij ambjentit, nuk e bën atë shumë të ndryshëm nga dhomat e paraburgimit. Dhoma e ajrimit në Elbasan shërbente edhe si dhomë dushi.

15. Shpeshherë, për arsye sigurie, punonjësit e policisë e kufizojnë kohën e ajrimit në më pak se 30 minuta. Në komisariatit e Bajram Currit të paraburgosurit mund të dilnin jashtë vetëm nga një ose nga dy për çdo herë, për shkak të rasteve të gjakmarrjes që mund të kishin me njëri-tjetrin, sepse disa prej tyre dyshohej të ishin përfshirë në vrasjen e të afërmeve të paraburgosurve të tjerë, ose dyshohej se kishin vjedhur familjet e të paraburgosurve të tjerë.

Vizitat e familjarëve

16. Të paraburgosurit mund të takohen me familjet e tyre një herë në 10 ditë. Në bazë të Rregullores së Paraburgimit takimet me anëtarët e familjes duhen të zgjasin deri në 15 minuta, kohëzgjatja e vizitave shkon nga 3 deri në 30 minuta. Nuk është vënë re asnjë kriter objektiv i cili do të përcaktonte kohëzgjatjen e tyre. Vendet e takimit përbëhen nga një dhomë ku gjendet një tavolinë dhe disa karrige, si dhe një polic që vëzhgon nga jashtë. Zakonisht, të paraburgosurit ndahen nga vizitorët me një mur ose me dy radhë rrjetash hekuri. Janë vënë re raste kur takimet janë bërë tek hyrja², ose tek lokali pranë³.

17. Në Bajram Curri të paraburgosurit flasin me familjet e tyre përmes një deriçe të vogël (një të çare në murin e oborrit). Shumë prej të paraburgosurve u ankuan për praninë e policisë gjatë vizitave. Një nga të paraburgosurit (rastësisht, ai që ndodhej në qeli më gjatë se të tjerët) e takonte familjen në derën e paraburgimit. Ndërsa në Kukës të gjithë të

² Raportuar në dhomat e paraburgimit të Tepelenës

³ Raportuar në dhomat e paraburgimit të Përmetit

paraburgosurit janë ankuar se programi i vizitave ishte i pakënaqshëm, për shkak se disa vizitorëve shpesh u duhej të prisnin me orë të tëra për të bërë një takim prej 10 minutash. Gjithashtu, ankesa të mëdha janë rregjistruar në lidhje me *modus operandi* (mënyrën e veprimit) aktuale dhe ambjentet e takimeve që bëheshin në oborr ku të paraburgosurit flisnin me vizitorët përmes një të çare të vogël në një derë çeliku. Vetë vizitorët i ndante nga dera e çelikut një rrjetë hekuri. Ankesa më të mëdha u bënë nga personat që, për shkak të kufizimeve, nuk mund të takonin fëmijët e tyre.

E drejta për avokat mbrojtës

18. Të gjithë të paraburgosurit e intervistuar pohuan se kishin akses për një avokat mbrojtës. Zakonisht takimet me avokatët mbrojtës bëhen nga ora 8:00 deri në orën 18:00. Disa nga të paraburgosurit u shprehën se megjithëse zakonisht e drejta e tyre për të pasur avokat respektohej, në disa raste, në dhomën ku zhvillohet takimi, rri gjithmonë një polic që ruan dhe që mund të dëgjojë bisedën. Disa të paraburgosur të tjerë thanë se nuk mund t'i takonin më avokatët e tyre, sepse nuk kishin me se t'i paguanin. Dukej se këta të paraburgosur nuk ishin në dijeni të faktit se në raste të tilla shteti mund të paguajë avokat për ta. Një i paraburgosur në dhomat e Durrësit u shpreh se ai nuk kishte pasur takim me avokat, sepse, duke qene se ai ishte nga Peshkopia, asnjë nuk ishte interesuar për të.

Gjendja e personave të dënuar me vendim të formës së prerë në paraburgim

19. Në të gjitha dhomat e paraburgimit të Shqipërisë ishin duke vuajtur dënimin persona të dënuar me vendim të formës së prerë. Në disa prej tyre numri i këtyre personave arrinte deri në 70-80% të numrit të përgjithshëm të personave që ndodheshin në paraburgim. Shumicës së personave të dënuar me vendim të formës së prerë u është dashur të qëndrojnë në paraburgim për disa muaj pas marrjes së vendimit të formës së prerë, por ka pasur edhe të tjerë, të cilëve u është dashur të rrinë në paraburgim për më tepër se një vit.

Ka të dhëna se dy të pandehur në Lushnje kanë vuajtur dënimin në dhomat e paraburgimit tre vjet pas dhënies së dënimit (respektivisht 18 dhe 13 vjet vjet burgim). Një i pandehur tjetër, i dënuar me burgim të përjetshëm kishte kaluar të paktën 6 muajt e parë në qelinë e paraburgimit me të pandehur të tjerë të dënuar me vendim të formës së prerë ose jo.

20. Burime të cilat nuk donin të identifikoheshin thanë se disa të dënuarve u ishte kërkuar të paguanin ryshfet për t'u transferuar në burgje. Ndërsa vizitonte dhomat e paraburgimit në Elbasan, stafit të OSBE-së i thanë se gjatë muajve të fundit ishin transferuar 3-4 të dënuar në sajë të "lidhjeve të tyre të veçanta".

Të paraburgosurit e huaj

21. Në dhomat e paraburgimit të Shqipërisë ndodhen edhe të paraburgosur të huaj. Në paraburgimin e Durrësit, një qytetar italian i akuzuar për trafik droge, u shpreh se ambasada e tij nuk ishte njoftuar. Në të njëjtin paraburgim ka pasur edhe tre qytetarë të tjerë të huaj, një prej të cilëve nga Bangladeshi dhe një nga Siria, të cilët u ankuan se edhe pse i kishin takuar një herë avokatët mbrojtës, ata nuk ishin në dijeni të akuzave kundër tyre, për shkak se nuk e kuptonin gjuhën shqipe dhe asnjë nuk e fliste gjuhën e tyre. Gjithashtu, gjatë periudhës kur u krye vëzhgimi, në dhomat e paraburgimit ndodheshin edhe një qytetar bullgar, një qytetar kanadez dhe dy nga Kosova.

Mosha e personave në paraburgim

22. Mosha minimale e personave të ndodhur në ambientete e paraburgimit ka qenë 14 vjeç. Minorenët e paraburgosur, të cilët kanë qënë nën moshën 16 vjeç, janë akuzuar për kryerje të krimeve të rënda, gjë kjo e cila është plotësisht në përputhje me ligjislacionin shqiptar. Mosha maksimale e personave në paraburgim ishte 70 vjeç.

Origjina e të paraburgosurve

23. Të paraburgosurit kanë qënë kryesisht vendas. Disa prej tyre, të cilët nuk ishin nga vendi ku ndodhen ambientet e paraburgimit i kanë raportuar Zyrave Rajonale se nuk e dinin arsyen pse ndodheshin në një vend larg nga vendi i tyre i banimit. Sipas policisë, këta persona ndodheshin atje për shkak se ky ishte vendi ku ata kishin kryer veprën penale.

24. Janë vënë re edhe raste kur të paraburgosurit janë mbajtur në dhomat e paraburgimit larg vendeve të tyre të origjinës për shkak të mbipopullimit, si për shembull të paraburgosur nga Durrësi që mbaheshin në Krujë, ose nga Kavaja, Elbasani dhe Laçi që mbaheshin në Librazhd. Gjithashtu të paraburgosur nga vende ku nuk ka ambiente paraburgimi mbahen larg vendit të tyre të origjinës.

Sjellja e policëve

25. Pavarësisht se të paraburgosurit ankohen së tepërmi për kushtet në ambientet e paraburgimit, për kushtet jo të mira sanitare, ose për probleme që lidhen me transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë, marrëdhëniet me policinë janë vënë re të jenë të mira. Ata nuk i vënë faj policisë në lidhje me kushtet në dhomat e paraburgimit. Kushtet e këqija zakonisht ata i lidhin me infrastrukturën e keqe dhe të varfër dhe jo me mënyrën sesi menaxhohet paraburgimi.

26. Nga ana tjetër, vetë policia, duke qënë se ky ishte shqetësimi i saj kryesor, fajësonte pushtetin qëndror për mos krijimin e një infrastrukture dhe kushteve më të mira në paraburgim. Gjithashtu, punonjësit e policisë ankoheshin se po bënin një punë që nuk u përkiste atyre dhe prisnin me padurim transferimin e ambienteve në Ministrinë e Drejtësisë.

27. Nuk ka pasur asnjë ankesë në lidhje me ndonjë keqtrajtim të bërë nga policia ndaj të paraburgosurve. Megjithatë, është tepër e vështirë për policinë për të mbajtur gjithmonë rregull në këto ambiente, duke marrë parasysh mbipopullimin e madh dhe gjendjen mendore të të paraburgosurve. Një shembull i tillë ishte edhe revolta që ndodhi në Shkodër në fillim të qershorit të vitit të kaluar, e cila solli konflikte të dhunshme midis policisë dhe disa të paraburgosurve. Si rrjedhojë, u plagosën disa oficerë policie, dhe ndoshta edhe disa të paraburgosur. Ky konflikt u pasua nga një grevë urie e cila zgjati disa ditë. Të paraburgosurit protestuan për kushtet e këqia, si dhe për vonesat e gjata në transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë. Gjithsesi, një numër i vogël i të paraburgosurve akuzuan se kohët e fundit kishin qënë dëshmitarë ose viktima të rrahjeve të personave të ndryshëm si pasojë e revoltës.

28. Nga ana tjetër, policët në detyrë në dhomat e paraburgimit kanë pohuar se ata përpiqen dhe bëjnë të pamundurën kur të paraburgosurit bëhen agresivë, por edhe pohuan se ata nuk mund të trajtohen gjithmonë "mirë". Gjithsesi policët përpiqen të sillen në mënyrë korrekte dhe t'i trajtojnë ata sipas rastit.

Çështje të tjera

29. Në Lushnje është vënë re një rast ku një i dënuar me vendim të formës së prerë, i cili duhej të lirohej pas kryerjes së dënimit, i duhej të rrinte atje edhe disa ditë apo edhe muaj më tepër, për shkak se ndodhej në paraburgim dhe policia nuk mund të autorizonte lirimin e tij. Policia e Shtetit nuk është institucioni kompetent për të urdhëruar lirimin e të burgosurve, kjo gjë duhet të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Prokuroria.

30. Në dhomat e paraburgimit në Shqipëri janë zhvilluar disa greva urie, si p.sh. në Shkodër, Vlorë, Lushnje, Përmet dhe Elbasan. Të paraburgosurit në grevë urie kanë kërkuar kushte më të mira, zgjidhjen e problemit të mbipopullimit dhe transferimin nëpër burgje.

Procesi i transferimit të dhomave të paraburgimit

31. Sikurse është përmendur edhe më sipër, procesi i transferimit të paraburgimit nga Ministria e Rendit Publik në Ministrinë e Drejtësisë, ka filluar ndërkohë me paraburgimin e Vlorës, i cili ka qenë i pari që është transferuar. Gjithsesi, në këtë moment, vihet re se ky proces është pezulluar për shkak të mosmarrëveshjeve mes Policisë së Shtetit dhe Policisë së Burgjeve. Sipas Drejtorit të Policisë së Burgjeve Piro Lutaj, varianti i miratuar nga Këshilli i Ministrave për transferimin e kësaj përgjegjësie, nuk është më i miri i mundshëm, dhe sjell në dritë një sërë problemesh që mund të zgjidheshin lehtësisht nëse ky proces bëhej në një mënyrë tjetër, të ndryshme nga ajo e transferimit vetëm të përgjegjesisë për shërbimin e sigurisë së brendshme në paraburgim. Varianti i tanishëm nuk siguron transferimin nën përgjegjësinë e Policisë së Burgjeve të shërbimeve të tjera si shërbimi mjeksor, ligjor, apo sigurimin e ushqimit.

32. Së bashku me Drejtorin e Përgjithshme të Burgjeve, Z. Ramadan Hasanaj, Z. Lutaj theksoi se varianti që mund të funksionojë më mirë është ai i rekomanduar fillimisht nga kjo drejtori, por i cili nuk u miratua nga Këshilli i Ministrave, për krijimin e qendrave të paraburgimit në bazë të ndarjeve të prefekturave. Në këtë mënyrë, pjesë të burgjeve ekzistuese, të cilët kanë kushte shumë më të mira se çdo paraburgim në Shqipëri, mund të përshtateshin, në mënyrë që të përdoreshin për qëllime paraburgimi. Kështu, jo vetëm që të paraburgosurit do të kenë kushte më të mira në vendet ku qëndrojnë, por ata mund të kenë akses në shërbime të tjera të ndryshme nga ato të sigurisë. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, rikonstruktimi i dhomave të paraburgimit të tanishme do të kërkonte, jo vetëm një faturë financiare shumë të lartë, por edhe shumë burokraci, dhe si rezultat do të kërkonte shumë kohë. Bazuar në përlllogaritjet e bëra nga kjo drejtori, vetëm fatura financiare që kërkoj sigurimi i kushteve minimale të pranueshme për paraburgimin e komisariatit të Vlorës, shkoi deri në 5 milionë lekë.

33. Gjithsesi, edhe varianti i propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, mund të krijojë probleme dhe, në një farë mënyre, nuk garanton respektimin e të gjitha të drejtave të të paraburgosurve. Në prefektura të tilla si ajo e Kukësit, bëhet i vështirë qëndrimi i të

paraburgosurve nga Bajram Curri, të rrijnë në paraburgimin e Komisarariatit të Kukësit, jo vetëm sepse do të kërkojë kohë, përpjekje dhe forca policore çdo herë që ata do të duhet të paraqiten në gjykatë, por edhe sepse vetë të paraburgosurit do të ndodhen larg vendeve të banimit dhe familjeve të tyre. Nga ana tjetër, varianti i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, mund të funksionojë më së miri për prefektura të tjera, ku qendra e prefekturës është afër qyteteve përreth.

34. Sipas Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, marrja nën përgjegjësi e paraburgimit të Vlorës, ishte një proces shumë i vështirë. Policia e Burgjeve siguron sigurinë e brendshme të ambienteve, në një kohë që është Policia e Shtetit ajo që mbulon sigurinë e jashtme, shërbimin mjekësor dhe ushqimin e të paraburgosurve. Gjithsesi, janë vënë re shumë përmirësime. Instalimi i dy kamerave të sigurisë, ndryshimi i disa dyerve shumë të vjetra të qelive, transferimi i menjëhershëm i të dënuarve me vendim të formës së prerë në burgje, si dhe ndarja e plotë e të paraburgosurve minorenë nga ata të rritur, kanë qenë disa nga ndryshimet e arritura.

35. Pas marrjes nën përgjegjësi të paraburgimit të Vlorës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve miratoi “Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Sistemit të paraburgimit”, e cila garanton më tepër respekt për të drejtat e paraburgosurve dhe u përshtatet standarteve ndërkombëtare për trajtimin e personave në burgim.

Rekomandime

A) Për Këshillin e Ministrave

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 15.05.2003, duhet të ndryshohet në mënyrë që të reflektojë situatën dhe nevojat e sistemit të paraburgimit, burimet njerëzore dhe financiare, si dhe gjeografinë e vendit. Mund të shikohet mundësia e adoptimit të një sistemi të përzierë dhomash paraburgimi, duke marrë në konsideratë propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për krijimin e qendrave të paraburgimit bazuar në ndarjet e prefekturave, në ato vende ku ka institucione burgimi ekzistuese, ndërsa në vendet e tjera të përdoren dhomat ekzistuese të paraburgimit, ku të gjitha këto do të jenë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë. Një sistem i tillë, jo vetëm që do të garantojë më tepër respekt për të drejtat njerëzore të të paraburgosurve, por do të sigurojë kalimin e përgjegjësive nga një ministri në tjetrën në mënyrë më të lehtë, si dhe do të reduktojë faturën financiare.

B) Deri në momentin kur të kompletohet kalimi i përgjegjësive për paraburgimin, rekomandimet e mëposhtme i drejtohen Ministrisë së Rendit Publik

B.1) Përmirësimi i kushteve fizike dhe higjienike

- a) Kushtet higjienike duhet të përmirësohen duke siguruar larjen më të shpeshtë të batanijeve dhe dyshekëve, sepse papastërtia e tyre krijon kushte për përhapjen e parazitëve dhe sëmundjeve të lëkurës mes të paraburgosurve.
- b) Duhet marrë në konsideratë mundësia për të krijuar hapësira frigoriferike. Të paraburgosurit nuk duhet t'i mbajnë ushqimet nëpër qeli.

- c) Duhet të bëhen marrëveshje të veçanta me ndërmarrjet elektrike dhe ujësjellësit për të përmirësuar pasjen e dritave dhe ujit në paraburgim, për më tepër edhe sepse mungesa e dritës përbën shqetësim për sigurinë në paraburgim.

B.2) Zbatimi i standarteve të të Drejtave të Njeriut

- d) Duke marrë për bazë madhësinë e dhomave të paraburgimit, moshën e të paraburgosurve dhe krimin për të cilin akuzohet se ka kryer secili prej tyre, duhet të sigurohet një ndarje më e mirë e këtyre të paraburgosurve.
- e) Të paraburgosurit duhet të informohen në mënyrë të qartë për të drejtën e tyre për të kontaktuar me një avokat, edhe në rast kur ata nuk kanë mundësi ta paguajnë vetë atë.
- f) Të paraburgosurit shtetas të huaj duhet të trajtohen me respekt dhe sipas ligjit. Duhet të sigurohet se ata janë informuar për akuzat kundër tyre në një gjuhë të kuptueshme për ta dhe se ata e kanë kuptuar përmbajtjen e çdo dokumenti që firmosin. Gjithashtu, qeveritë e tyre duhet të informohen menjëherë.
- g) Shërbimi mjeksor duhet të jetë efektiv dhe i baranartë për të gjithë. Të paraburgosurit e sëmurë mendorë duhet të dërgohen në spitale që sigurojnë shërbim mjeksor profesional për shëndetin mendor. (*referoju paragrafit no. 8*)
- h) Rregullorja e Paraburgimit e Ministrisë së Rendit Publik, nuk u përshtatet standarteve ndërkombëtare për trajtimin e personave në burgim. Për shembull, ajo kufizon kohën e takimeve me familjen deri në 15 minuta në dhjetë ditë, duke lënë vend për abuzime, si lejimi i takimit me familjen vetëm për 2-3 minuta. Kjo Rregullore duhet të përshatet me “Rregulloren për Organizimin dhe Funkionimin e Sistemit të paraburgimit” të miratuar kohët e fundit nga Ministria e Drejtësisë.
- i) Duhet të bëhen marrëveshje mes Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve përsa i përket lirimit të të dënuarve me vendim të formës së prerë që e kanë ezauruar gjithë dënimin e tyre në paraburgim. (*referoju paragrafit nr. 29*)
- j) Të gjithë të dënuarit me vendim të formës së prerë duhet të çohen menjëherë nëpër burgje. Ky transferim duhet të jetë efektiv dhe transparent. Duhet të hetohen dhe ndiqen penalisht rastet e pretenduara për marrje ryshfetesësh me qëllim transferimin e të dënuarve në burgje. (*referoju paragrafit nr. 20*)

Konkluzione

Gjendja e paraburgimit në Shqipëri vazhdon të mbetet problematike. Kushtet fizike të dhomave të paraburgimit janë duke u përkeqësuar. Mbipopullimi gjithashtu krijon një pengesë të madhe për të siguruar një trajtim normal minimal për të paraburgosurit. Të gjitha këto probleme, së bashku me trajtimin e minoreneve dhe grave, duket se do të jenë më të thjeshta për t’u zgjidhur nëse paraburgimi do të ishte nën Ministrinë e Drejtësisë, gjë që do të thoshte se vendimet do të duhej të merreshin në mënyrë vertikale, brenda së njëjtës ministri, dhe jo në mënyrë horizontale, nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Rendit Publik dhe anasjelltas. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë ka më shumë mundësi se sa Ministria e Rendit

Publik për të trajnuar oficerët e policisë që merren me të paraburgosurit. Por ky proces duhet bërë duke marrë parasysh situatën e institucioneve të paraburgimit dhe të burgimit në Shqipëri, si dhe duhet të kërkojë një faturë financiare normale.

Aneksi I

Pyetësori i vëzhgimit të gjendjes së paraburgimit

1. Emri i komisarariatit:
2. Drejtori Policisë:
3. Shef i Komisararitit:
4. Numri i policëve:
5. Numri i policeve:
6. Numri i personave në detyrë gjatë gjithë kohës:
7. Numri i dhomave të paraburgimit:
8. Numri i personave në çdo dhomë:
9. Cili është vlerësimi juaj i përgjithshëm mbi kushtet:
10. Numri i përgjithshëm i të paraburgosurve meshkuj:
11. Për çfarë krimesh akuzohen meshkujt
12. Numri i përgjithshëm i të paraburgosurave femra:
13. Për çfarë krimesh akuzohen femrat
14. Numri i përgjithshëm i të paraburgosurve minorene:
15. Për çfarë krimesh akuzohen minorenet
16. A kanë të paraburgosurit mundësi të kontaktojnë me avokat? A kryhen këto takime privatisht?
17. A ka të dënuar me vendim të formës së prerë në paraburgim? Nëse po, kur është marrë ky vendim?
18. Çfarë kushtet sanitare ka paraburgimi dhe a kanë të paraburgosurit akses në to?
19. A ka qytetarë të huaj në paraburgim? Çfarë shtetësie kanë ata?
20. Cila është mosha e të paraburgosurve, më i riu dhe më i vjetri.
21. Cila është periudha më e gjatë që një person ka ndenjur në paraburgim?
22. A kanë vizita nga familjet? Sa shpesh?
23. Për sa kohë mund të kryjnë ushtrime fizike në ditë?
24. A janë të paraburgosurit nga e njëjta zonë ku edhe gjenden në paraburgim, dhe nëse jo, nga janë dhe pse gjenden në këtë paraburgim?
25. Komente të tjera, ose ankesa në lidhje me trajtimit, ose ankesa nga ana e policëve.

Aneksi II

Komisariatet e Policisë që kanë dhoma paraburgimi:

1. Berat
2. Skrapar
3. Durrës
4. Krujë
5. Dibër
6. Mat
7. Elbasan
8. Librazhd
9. Gramsh
10. Fier
11. Lushnje
12. Gjirokastrë
13. Përmet
14. Tepelenë
15. Kukës
16. B. Curri
17. Korçë
18. Pogradec
19. Lezhë
20. Mirditë
21. Kurbin
22. Shkodër
23. Pukë
24. Vlorë
25. Sarandë

Komisariatet e Policisë që nuk kanë dhoma paraburgimi:

1. Kuçovë
2. Bulqizë
3. Peqin
4. Mallakastër
5. Has
6. Ersekë
7. Devoll
8. M. Madhe
9. Tiranë
10. Kavajë
11. Delvinë

Aneksi III

Statistika të gjendjes së paraburgimit në 2 qershor 2003

Komisariati i Policisë	Kapaciteti	Nr.i personave prezent	Të dënuar me vendim të formës së prerë	Minorenë	Të huaj
Berat	55	47	16		
Skrapar	14	16	9	2	
Durrës	80	184	10	12	8
Krujë	30	48	22	3	
Dibër	30	25	22		
Mat	30	30	14	1	
Elbasan	70	84	34	4	
Librazhd	20	22	16	2	
Gramsh	12	16	8		
Fier	50	146	30	13	
Lushnje	35	71	26	6	
Gjirokastër	30	40	10		
Përmet	14	15	8		
Tepelenë	25	20	6		
Kukës	40	72	22	6	
Tropojë	15	27	4	1	
Korçë	45	100	40	5	
Pogradec	30	34	15	2	2
Lezhë	24	45	7		
Mirditë	12	15	5		
Kurbin	24	51	4	8	
Shkodër	50	105	22	6	1
Pukë	22	35	13	1	
Vlorë	42	106	13	7	
Sarandë	30	42	8	1	
TOTALI	825	1416	384	79	11